



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

VENDIM

Nr.1, datë 05/03/2025

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT P.F “ANNA XHEKA” PËR
NDRYSHIMIN (SHFUQIZIMIN) E PIKËS NR.3 TË VENDIMIT NR.7,
DATË 18.07.2024 TË KBU ERZEN “KY VENDIM ËSHTË I VLEFSHËM
VETËM NËSE SUBJEKTI ËSHTË I PAJISUR ME KONTRATË PËR
PËRDORIMIN E HAPËSIRËS SË PLAZHIT PËR PARCELËN DR-765,
SIPAS VKM NR.171, DATË 27.03.2019”.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

KONSTATOI SE:

1.Subjekti Anna Xheka është një subjekt tregtar person fizik i regjistruar pranë qendrës tregtare të regjistrimit me nipt L51705503D dhe ka si objekt të aktivitetit të sajë **“menaxhim strukture akomoduese, plazh privat,** ndërmjetësim ligjor, aktivitete juridike, të konsulencës manaxheriale, këshillime të bizneseve, studime të ndryshme” ashtu sic rezulton nga ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit.

2.Në datë 18.07.2024 subjekti “Anna Xheka” me vendim Nr. 7, datë 18/07/2024 të Këshillit të Basenit Ujor Erzen (KBU Erzen) është pajisur me autorizim “për përdorim burimi ujor sipërfaqësor” (për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim) Nr. 12/6 Prot., datë 18.07.2024 Nr. Serial: 000003.

Në pikën 3, të vendimit Nr. 7, datë 18/07/2024, të Këshillit të Basenit Ujor Erzen (KBU Erzen) përcaktohet se:

Ky vendim është i vlefshëm vetëm nëse subjekti është i pajisur me Kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit për parcelën DR-765, sipas VKM. 171, datë 27.03.2019.

Për tu pajisur me këtë autorizim subjekti sipas VKM-së nr. 550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre” ka plotësuar formularin 12 “kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim” duke paraqitur dokumentacion teknik si më poshtë:

- I. Studimi hidrologjik;
- II. Projekti i skemës së shfrytëzimit;
- III. Plan biznesi;
- IV. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- V. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, të kryera në laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi. (aplikohet në rastet e pishinave, akuaparqeve).
- VI. **Marrëveshjen me njësinë vendore, për kryerjen e aktivitetit (sipas VKM nr. 441, datë 17.5.2017 për një shtesë në vendimin nr.321, datë 28.5.2014).**

Ne plotësim të pikës VI të formularit subjekti ka paraqitur **“Kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit/kontratë qiraje” datë 12.06.2024 nënshkruar midis Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Bashkisë Durrës dhe Subjektit Anna Xheka.**

Objekti i kësaj kontratë është dhënia në përdorim e hapësirës së plazhit dhe/ose e shërbimit sipas rastit, për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në vendimin nr. 171, datë 27.03.2019, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar. Kohëzgjatja për një periudhë prej 1 viti, për sezonin turistik 2024.

Qëllimi i parashikimit të dokumentit në pikën VI të formularit 12 është që autorizimi **për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim** ti jepet një subjekti, i cili ushtron aktivitetin në përputhje me VKM-në për shfrytëzimin e plazheve fushë e cila është gjithmonë në ndryshim dhe përmirësim nga ana e Këshillit të Ministrave, e aktualisht në fuqi është VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e cila ka shfuqizuar VKM-në

Nr. 171/2019 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” **por objekti i VKM-së Nr. 649, datë 16.10.2024 është i njëjtë.**

Që të zotërosh një autorizim të vlefshëm **për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim** duhet detyrimisht të kesh **në lidhje fizike me një parcelë plazhi.**

3. Më datë 19.06.2024 Subjekti “Anna Xheka” P.F, nëpërmjet aplikimit në sistemin e-leje “Aplikim për përdorim burimi ujor” me Nr.AN190620240002, datë 19.06.2024, ka paraqitur “Kërkesë për ndryshimin e kushteve të lejes/autorizimit”, nëpërmjet të cilit kërkon ndryshimin (shfuqizimin) e pikës 3, të Vendimit Nr.7, datë 18.07.2024, të KBU Erzen , e cila përcakton se “Ky vendim është i vlefshëm vetëm nëse subjekti është i pajisur me Kontratë për përdorimin e hapësirës së plazhit për parcelën DR-765, sipas VKM Nr.171, datë 27.03.2019” me arsyetimin se, VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, ka shfuqizuar VKM-në Nr. 171/2019 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

4. Agencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore pasi shqyrtoi aplikimin Nr.AN190620240002, datë 19.06.2024 i ka kthyer përgjigje subjektit ku e informon ndër të tjera se:

...Referuar pikës 10, të VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020, nga kontrolli në përmbajtje i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se duhet të kryhet pagesa e tarifës së shqyrtimit të aplikimit sipas VKM-së Nr.1014, datë 16.12.2020.

Gjithashtu ju sqarojmë se, AMBU për këtë kërkesë do të kërkojë mendimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 649, datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”...

5. Në datë 08.01.2025 subjekti pasi ka kryer pagesën e tarifës përkatëse ka paraqitur dhe pretendimet e tij, duke ngarkuar shkresën “Plotësim Dokumentacioni” datë 08.01.2025, duke pretenduar si më poshtë:

....Ju lutem gjeni bashkëngjitur pagesën e tarifës së aplikimit.

Ndërkohë modestisht edhe në cilësinë e Profesores së lëndës “E Drejta Administrative” në UAMD Durrës, me lejoni të përcjell argumentat juridikë lidhur me sqarimin Tuaj, sipas të cilit: “...

për këtë kërkesë timen do të kërkon mendimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e VKM Nr. 649, date 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

Në parim vlerësohet marrja e mendimit ndërinstitutional kur është rasti, por juridikisht në rastin objekt të kësaj kërkesë, situata e faktit (shfuqizimi i VKM 171/2019) përjashton çdo mendim apo qëndrim ndryshe me këtë situatë fakti argumentuar si vijon:

- Kjo kërkesë nuk është kërkesë tipike e një subjekti për ndryshim të kushteve të lejës autorizimit për arsye objektive apo subjektive të tij. Është një kërkesë atipike që diktohet nga shfuqizimi i VKM nr.171/2019 me një akt të Këshillit të Ministrave (VKM 649/2024) i cili është i detyrueshëm për këdo, për subjektin apo institucionet shtetërore.

- Në thelb/përmbajtje, pika 3 e Vendimit Nr.7 datë 18.07.2024 të ish KBU Erzen është shfuqizuar menjëherë me shfuqizimin e VKM 171.2019.

- Kërkesa ime ka të bëjë me formalizimin në dokument /akt administrativ të këtij shfuqizimi në përmbajtje të vendimit si më sipër, i cili ka ndodhur për shkak të shfuqizimit të VKM 171/2019.

- Mendimi i institucioneve të tjera në këtë rast nuk mund të prevalojë dhe as të ndryshojë faktin që VKM nr 171/2019 është shfuqizuar dhe kështu është shfuqizuar në çdo akt tjetër të lidhur me të siç është Vendimi nr.7 datë 18.07.2024 i ish KBU Erzen.

- Në referim të Ligjit 29/2024 "Për burimet ujore", Kreu II, Seksioni 1, institucionet që kanë kompetencën lëndore të formalizimit të këtij ndryshimi, nuk janë institucionet përgjegjëse për zbatimin e VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit". Në referim të nenit 108 të K.Pr.A i cili citon: "Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a - kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij" mendimarrja është absolutisht e pavlefshme si e dhënë nga organi jokompetent dhe në kushtet kur procedura e parashikuar për kërkesën objekt nuk kërkon marrjen e mendimit të këtyre institucioneve.

6. Në këto kushte Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Bashkisë Durrës me kërkesë për informacion lidhur me aplikimin e subjektit "Anna Xheka" P.F për ndryshimin (shfuqizimin) e pikës 3 të Vendimit Nr.7, datë 18.07.2024 të KBU Erzen, duke i kërkuar në cilësinë e institucioneve zbatuese të VKM-së Nr. 649, datë 16.10.2024 për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", si dhe referuar hartës së re të stacioneve të plazhit, informacion nëse subjekti ka detyrimin për lidhjen e kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit për parcelën DR-765 për ushtrimin e aktivitetit për lojra për argëtim.

7. Agjencia Kombëtare e Bregdetit me kthim përgjigje nr. 516/1 Prot datë, 19.02.2025 ndër të tjera ka sqaruar sa më poshtë:

-Ushtrimi i veprimtarisë së stacioneve të plazhit, rregullohet sipas Vendimit nr. 649. Datë 16.10.2024 të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" (në vijim VKM 649/2024). Ky vendim ka shfuqizuar Vendimin nr 171, datë 27.03.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" të ndryshuar.

-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 649/2024, përcakton kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacioneve të plazhit në të gjitha zonat bregdetare, si dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat janë të identifikuar si zona të përshtatshme për plazhe, me qëllim ofrimin e kushteve të përshtatshme e të standartevecilësore për pushuesit.

-Për sezonin turistik veror 2025, referuar hartës së stacioneve të plazheve të propozuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe të miratuar nga Komiteti I Menaxhimit të Sezonit Turistik, parcela e plazhit me kod identifikues DR-765 identifikohet e tipologjisë “Publike” të cilat administrohen/menaxhohen e mirëmbahen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe shërbejnë si plazhe publike, sipas nenit 5/4 të VKM-së 649/2024, ku përcaktohet:

KMST-ja ka si detyrë:

Miratimin e listes së plazheve dhe hartës së stacioneve të plazheve, sipas tipologjisë së tyre, si dhe plazheve publike, bazuar në propozimet e njërive të vetëqeverisjes vendore, të cilat pajisen me një numër të vecantë identifikues, që publikohet në momentin e hapjes së kërkesës on-line.

-Plazhet publike, të cilat në hartën e plazheve, paraqiten me ngjyrë jeshile, nuk mund të aplikohen nga subjektet për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, pasi janë plazhe për përdorim të lirë nga pushuesit.

-Gjithashtu në nenin 7 I VKM-së 649/2024 përcaktohen kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit, më konkretisht në pikën 3/a/b, ku ndër të tjera parashikohet: Për ushtrimin e veprimtarisë si stacion plazhi, subjektet duhet të disponojnë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para/në afërsi të strukturës akomoduese, ndaj aktualisht për sezonin turistik veror 2025, aplikimet e subjektit Anna Xheka, në parcelat aplikuese të plazhit, janë refuzuar duke informuar nëpërmjet systemin e-Albania për këto arsye..

8. Në këto kushte, AMBU nga sa më lartë, vijoi me përgatitjen e Raportit Teknik e ligjor për lidhur me kërkesën e subjektit p.f “Anna Xheka” për ndryshimin (shfuqizimin) e pikës nr.3, të vendimit nr.7, datë 18.07.2024, të KBU Erzen dhe e paraqiti për miratim në Këshillin e Basenit Ujor Erzen.

9.Në datë 5.03.2025 u zhvillua mbledhja e radhës e KBU Erzen, ku pjesë e rendit të ditës ishte edhe shqyrtimi i kërkesës së subjektit “Anna Xheka”. Nga sa parashtruar edhe më lart, KBU Erzen vlerëson se kërkesa për ndryshimin e kushtit të përcaktuar në pikën 3, të vendimit Nr. 7, datë 18/07/2024, të Këshillit të Basenit Ujor Erzen, duhet të refuzohet. Kjo pasi synimi për të cilin është vendosur ky kusht, lidhet me faktin që autorizimi të jepet për ato subjekte, të cilat e ushtrojnë aktivitetin në përputhje me VKM-në për shfrytëzimin e plazheve, e aktualisht në fuqi është VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, e cila ka shfuqizuar VKM-në Nr. 171/2019 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” por objekti i VKM-së Nr. 649, datë 16.10.2024 është i njëjtë.

Fakti që subjekti Anna Xheka nuk mund të sigurojë një marrëveshje për përdorimin e hapësirës së plazhit për parcelën DR-765 pasi ajo nuk plotëson kushtet dhe kriteret sipas

VKM-së nr. 649. Datë 16.10.2024 të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” (subjektet duhet të disponojnë një strukturë akomoduese të kategorizuar nga ministria përgjegjëse për turizmin, me hapësirë plazhi para/në afërsi të strukturës akomoduese) kjo nuk përbën shkas për ndryshimin e kushteve të autorizimit.

**PËR KËTO ARSYE
V E N D O S I:**

Refuzimin e kërkesës së subjektit p.f “Anna Xheka” për ndryshimin (shfuqizimin) e pikës nr.3 të Vendimit nr.7, datë 18.07.2024 të KBU Erzen.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBU ERZEN

AFRIM QËNDRO

